

## 4. Efekti serrë i gazeve “Greenhouse”

Me anë të këtyre eksperimenteve do të mund të vëzhgoni se si ndikojnë gazet serrë në klimën globale? Vëzhgoni atmosferën në periudha të ndryshme, si gjatë moshës së akullt dhe sot. Shpjegoni çfarë ndodh kur ju shtoni sasinë e reve në atmosferë. Ndryshoni përqendrimin e gazeve serrë dhe vëzhgoni se si ndryshon temperatura e mjedisit dhe më pas krahasoni efektin e paneleve diellore. Zmadhoni skemën dhe vëzhgoni se si drita vepron me molekulat. Cilat nga gazet atmosferike kontribuojnë në efektin ”greenhouse”.

### Shembull

- Përshkruani efektin “greenhouse” të gazeve ndaj fotoneve dhe temperaturës.
- Përshkruani efektin e reve ndaj fotoneve dhe temperaturës.
- Krahasoni efektin ” greenhouse” të gazeve me efektin e paneleve diellore.
- Përshkruani bashkëveprimin e fotoneve me gazet atmosferike.
- Shpjegoni pse efekti serrë ndikon në rritjen e temperaturës.